



REPUBLIKA E KOSOVËS / REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE MITROVICË - DEGA E GJYKATËS VUSHTERRI

Numri i lëndës: 2022:176402

Datë: 30.04.2024

Numri i dokumentit: 05640736

P.nr.338/2022

NË EMËR TË POPULLIT

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË – DEGA NË VUSHTERRI - Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal, gjyqtari i vetëm gjykues Agron Maxhuni, në çështjen penale kundër të pandehurit A.S. nga Vushtrria, për shkak të veprës penale Pengimi i personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare nga neni 401 par.5 në lidhje me par.1 të KPRK-së, sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore në Mitrovicë - Departamentit të Përgjithshëm PP-II.nr.157/22 e datës 23.09.2022, pas përfundimit të shqyrtimit gjyqësor të mbajtur më datë 22.04.2024, në të cilin ishin të pranishëm Prokurori i Shtetit Arjan Xhema, i pandehuri A.S. dhe mbrojtësi i tij sipas detyrës zyrtare av.Ekrem Salihu, më dt.22.04.2024 mori dhe publikisht shpalli, ndërsa me datë 30.04.2024 përpiloi këtë:

A K T G J Y K I M

I PANDEHURI: A.S. me nofkën K., nga i ati B., e ëma F., e gjinisë H., i lindur më datë..., nga Vushtrria, me numër personal ..., ka të kryer shkollën e mesme, i pa punë, i pa martuar, i gjendjes së dobët ekonomike, më parë i pa gjykuar, shqiptar, shtetas i Republikës së Kosovës.

ËSHTË FAJTOR

SEPSE: Më 24.01.2022, rreth orës 15:30, në Vushtrri në rr. “Marin Barleti”, me forcë ka penguar personat zyrtar në kryerjen e veprimeve zyrtare, në atë mënyrë që me rastin e kryerjes së planit operativ të policisë, patrulla e policisë në përbërje të zyrtarëve policor – të dëmtuarve J.Sh. e B.O., i kanë ndaluar dy persona për shkak të dyshimit për përdorimin e narkotikëve, me rastin e legjitimit të tyre dhe kontrollit, i pandehuri ka dal para zyrtarëve policor, nga të njëjtit ka kërkuar dokumentet dhe iu ka thënë: “Kush jeni ju që të ndaloni dhe të kërkonit letërnjoftime”, me të cilin rast personat e ndaluar për shkak të kontrollit ia kanë dalë që të ikin nga vendi i ngjarjes,

- Me këtë ka kryer veprën penale Pengimi i personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare nga neni 401 par.5 në lidhje me par.1 të KPRK-së.

Andaj, gjykata konform dispozitave të neneve 4, 7, 17, 21, 38, 39, 40, 42, 46, 47, 48, 49, 69, 70 dhe nenit 401 par.5 në lidhje me par.1 të KPRK-së, si dhe nenit 241, 364, 449 dhe 462 të KPPK-së, e

G J Y K O N

Të pandehurit: A.S. i shqipton DËNIM ME BURG në kohëzgjatje prej tetëmbëdhjetë (18) muaj, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri nuk kryen veprë penale në periudhën verifikuese në kohëzgjatje prej dy (2) vite.

DETYROHET i pandehuri që në emër të kompensimit të viktimave të krimit të paguajë shumën prej njëzetë euro (20€), si dhe në emër të paushallit gjyqësor të paguajë shumën prej pesëdhjetë euro (50€), të gjitha këto në afat prej 15 ditësh prej ditës së marrjes së formës së prerë të këtij aktgjykimi nën kërcënimin e ekzekutimit të dhunshëm.

Palët e dëmtuara udhëzohen që kërkesën pasurore juridike lidhur me këtë çështje penale ta realizojnë në kontest të rregullt civil.

A r s y e t i m

Pjesa hyrëse e aktgjykimit të arsytuar

Prokuroria Themelore në Mitrovicë – Departamenti i Përgjithshëm ka ngritur aktakuzë PP-II.nr.157/22 e datës 23.09.2022, kundër të pandehurit A.S. nga Vushtrria, për shkak të veprës penale Pengimi i personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare nga neni 401 par.5 në lidhje me par.1 të KPRK-së.

Deklarimi i të pandehurit lidhur me pranimin e fajësisë

Në seancën e shqyrtimit gjyqësor të mbajtur më dt.22.04.2024, ku pas leximit të aktakuzës nga ana e prokurorit të shtetit, në kuptim të nenit 241 të KPPK-së, i pandehuri A.S. ka deklaruar se e pranon fajësinë, është penduar thellë për kryerjen e veprës penale duke i premtuar gjykatës se nuk do të përsërisë më vepra penale të kësaj natyre apo natyrës tjetër.

Deklarimet e palëve lidhur me pranimin e fajësisë

Prokurori i shtetit lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit ka deklaruar se në pajtim me nenin 242 par.2 të KPPK-së, pajtohet me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, pranimi i fajësisë është i vullnetshëm, i bazuar në provat materiale si në aktakuzë, pasi që i njëjti pranim është bërë edhe në konsultim me av. mbrojtës. Ndërsa në fjalën përfundimtare ka deklaruar se konsideron se në shqyrtimin e sotëm gjyqësor në tërësi është vërtetuar se i pandehuri e ka kryer veprën penale, e cila përmes aktakuzës i vihet në barrë. Tutje ka shtuar se kjo rrjedh nga pranimi i fajësisë nga ana e të pandehurit, e cila është në pajtim me të gjitha provat që gjenden në shkresat e lëndës dhe në tërësi mbetet pranë aktakuzës së ngritur, dhe i propozon gjykatës që

të pandehurin ta shpallë fajtor dhe ta dënojë sipas ligjit.

Mbrojtësi i të pandehurit sipas detyrës zyrtare av. Ekrem Salihu, lidhur me pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, ka deklaruar se pas konsultimeve me të pandehurin dhe sqarimeve nga ana e tij se pranimi i fajësisë është rrethanë lehtësuese me rastin e shqiptimit të dënimit, i njëjti në mënyrë vullnetare pranoj kryerjen e veprës penale. Ndërsa në fjalën përfundimtare ka deklaruar se i propozon gjykatës që me rastin e shqiptimit të llojit të dënimit, të ketë parasysh rrethanat lehtësuese të parapara me nenin 70 dhe 71 të KPRK-së siç janë: pranimi i fajësisë, mosha e re me rastin e kryerjes së veprës penale, faktin se i njëjti me parë nuk ka qenë i gjykuar si dhe gjendjen e tij jo të mirë materiale, meqenëse i njëjti është i pa punë.

I pandehuri në fjalën përfundimtare ka deklaruar se mbetet në tërësi pranë thënieve të dhëna nga av. mbrojtës.

Vlerësimi i Gjykatës lidhur me plotësimin e kushteve për pranimin e fajësisë

Në shqyrtimin gjyqësor, gjyqtari i vetëm gjykues pas dëgjimit të palëve, ka marrë aktvendim me të cilin e ka pranuar pranimin e fajësisë nga i pandehuri, ngase ka konstatuar se janë plotësuar të gjitha kushtet ligjore për një gjë të tillë. Në këtë aspekt gjyqtari i vetëm gjykues ka konstatuar se i pandehuri e ka kuptuar natyrën dhe pasojat e pranimit të fajësisë, se pranimi i fajësisë është bërë vullnetarisht nga i njëjti, se pranimi i fajësisë mbështetet në provat materiale të cilat mbështesin aktakuzën, si: Procesverbal i marrjes në pyetje për ankuesin B.O., i datës 08.08.2022, Procesverbal i marrjes në pyetje për dëshmitarin Jeton Shala, i datës 09.08.2022, Raporti fillestar i incidentit nr.2022-BD-063, i datës 24.01.2022, Raport i policit i datës 24.01.2022, Procesverbal i marrjes në pyetje për të dyshuarin A.S. dhe shkresat e tjera, si dhe aktakuza nuk përmban asnjë shkelje të qartë ligjore ose gabime faktike.

Gjendja faktike e vërtetuar

Bazuar në të lartcekurat, gjyqtari i vetëm gjykues ka vërtetuar këtë gjendje faktike, se i pandehuri me dashje ka kryer veprën penale Pengimi i personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare nga neni 401 par.5 në lidhje me par.1 të KPRK-së, në kohën, vendin dhe mënyrën e përshkruar si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

Në nenin 409 par.1 të KPRK-së është përcaktuar se formën themelore të veprës penale Pengimi i personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare e kryen “*Kushdo që me forcë apo kanosje serioze, pengon ose tenton të pengojë personin zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare ose duke përdorur mjetet e njëjta e detyron atë të kryejë detyrën zyrtare, dënohet me burgim prej tre (3) muaj deri në tre (3) vjet*”, ndërsa forma e kualifikuar e kësaj vepre penale është përcaktuar në par. 5 të po këtij neni i cili parasheh se “*Nëse vepra penale nga paragrafi 1. ose 2. i këtij neni kryhet ndaj gjyqtarit, prokurorit, zyrtarit të gjykatës, zyrtarit të prokurorisë apo personit të autorizuar nga gjykata dhe prokuroria zyrtarit policor, zyrtarit doganor, zyrtarit ushtarak apo zyrtarit të shërbimit korrektues gjatë ushtrimit të funksioneve të tyre zyrtare, kryesi dënohet me burgim prej një (1) deri në pesë (5) vjet*”.

Andaj, bazuar në të lartcekurat, gjykata ka vendosur që të pandehurin ta shpall fajtor për kryerjen e veprës penale Pengimi i personit zyrtar në kryerjen e detyrave zyrtare nga neni 401 par.5 në lidhje me par.1 të KPRK-së, ngase veprimet e të njëjtit përmbajnë të gjitha tiparet e kësaj vepre penale dhe se për të njëjtat është edhe penalisht përgjegjës.

Gjetjet e gjykatës lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit

Lidhur me llojin dhe lartësinë e dënimit, me rastin e shqiptimit të dënimit ndaj të pandehurit, bazuar në nenin 69 dhe 70 të KPRK-së, duke vlerësuar rrethanat lehtësuese dhe rënduese, kjo gjykatë si rrethana lehtësuese gjykata ka vlerësuar pranimin e fajësisë nga ana e të pandehurit, premtimin e të njëjtit se në të ardhmen nuk do të përsëris vepër penale të kësaj apo natyrës tjetër, mw parw nuk ka ra ndesh me ligjin si dhe pendimin nw kryerjen e veprës penale, ndwrsa si rrethana rënduese ka gjetur shkallën e përgjegjësisë penale, me ç'rast vepra penale është kryer me dashje nga ana e të pandehurit, si dhe intensitetin e rrezikimit të vlerës së mbrojtur, në rastin konkret dëmin e shkaktuar ndaj palëve të dëmtuara – zyrtarëve të policisë.

Sipas bindjes së gjykatës, dënimi me burg në kohëzgjatje prej tetëmbëdhjetë (18) muaj, i cili dënim nuk do të ekzekutohet nëse i pandehuri nuk kryen vepër penale në periudhën verifikuese në kohëzgjatje prej dy (2) vite, është dënim i drejtë, në harmoni me peshën e veprës penale dhe shkallën e përgjegjësisë së të pandehurit.

Gjykata, duke vlerësuar të gjitha këto rrethana ka gjetur se me këtë dënim të shqiptuar ndaj të pandehurit do të arrihet qëllimi i dënimit nga neni 38 i KPRK-së, i cili konsiston në parandalimin e të njëjtit nga kryerja e veprave tjera penale në të ardhmen dhe të bëjë rehabilitimin e tij, të parandaloj personat e tjerë nga kryerja e veprave penale dhe të shpreh gjykimin shoqëror për veprën penale, ngritjen e moralit dhe forcimin e detyrimit për respektimin e ligjit.

Arsyet lidhur me kërkesën pasurore juridike, shpenzimet e procedurës dhe kompensimin e viktimave të krimit

Vendimin lidhur me kompensimin e dëmit ndaj palës së dëmtuar, gjykata e ka marrë në bazë të nenit 462 të KPPK-së, në të cilin parashihet se: *“Në aktgjykim me të cilin i akuzuari shpallet fajtor, gjykata mund të vendosë për kërkesën pasurore juridike të të dëmtuarit në tërësi ose pjesërisht dhe për pjesën e mbetur e udhëzon në kontest civil. Kur të dhënat e mbledhura në procedurë penale nuk paraqesin bazë të sigurt për gjykim të plotë e as të pjesërishtëm, gjykata e udhëzon të dëmtuarin që kërkesën pasurore juridike mund ta realizojë në kontest civil”*.

Vendimin mbi shpenzimet e procedurës penale gjykata e ka marrë në bazë të nenit 449 par. 2 nën par. 2.6 të KPPK-së.

Vendimin për taksën e kompensimit të viktimave të krimit gjykata e ka marrë në bazë të nenit 39 par 3 pika 3.1 të Ligjit Nr. 05/L-36 për Kompensimin e Viktimave të Krimit.

Andaj, gjykata duke u bazuar në arsyet e lartcekura ka vendosur si në dispozitiv të këtij

aktgjykimi.

GJYKATA THEMELORE NË MITROVICË – DEGA NË VUSHTRRI
Departamenti i Përgjithshëm – Divizioni Penal
P.nr.338/2022, datë 30.04.2024

GJYQTARI
Agron Maxhuni

KËSHILLË JURIDIKE: Kundër këtij aktgjykimi palët kanë të drejtë ankese në Gjykatën e Apelit në Kosovë, në afat prej tridhjetë (30) ditësh, llogaritur nga dita e pranimi të aktgjykimit. Ankesa dorëzohet përmes kësaj Gjykate, në kopje të mjaftueshme për palët dhe për gjykatën.